



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCIVE
DREJTORIA E PERGJITHSHEME E THESARIT
DREJTORIA E THESARIT

Nr. 3232 prot.

Tirane 7.05, 2007

UDHEZIM

Nr. 7 date 7.05.2007

PER

PERDORIMIN E FONDIT TE SHPRONESIMEVE

Ne mbeshtetje te pikes 4 te nenit 102 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise dhe te nenit 8 te ligjit Nr.9601 date 28.07.2006 "Per disa ndryshime ne ligjin nr.9464 date 28.12.2006 "Per buxhetin e shtetit te vitit 2006" per perdorimin e fondit te shpronesimeve

UDHEZOJ:

1. Ministrite dhe Institucionet qendrore te paraqesin ne Ministrine e Financave - Drejtorine e Pergjithshme te Thesarit, kerkesen per shpronesim e cila duhet te kete bashkangjitur Vendimin e Keshillit te Ministrave per shpronesimin e kerkuar.
2. Ministria e Financave, e miraton kerkesen ne rast se shpronesimi behet per projekte te programeve prioritare te Qeverise dhe nese fondet, ne llogarine "Fondi i shpronesimeve" prane Bankes se Shqiperise, jane te mjaftushme.
3. Pagesa e te shpronesuarve te behet si vijon:
 - Ministrite dhe institucionet qendrore perkatese, ne mbashtetje te Vendimit te Keshillit te Ministrave, per çdo individ apo subjekt te shpronesuar krijon dosjen perkatese, ne perputhje me Ligjin Nr.8561 date 22.12.1999 "Per shpronesimet dhe marrjen ne perdorim te perkohshem te pasurise prone private, per interes publik".
 - Me perfundimin e kompletimit ligjor te dosjes, Ministrite dhe Institucionet qendrore perkatese hartojne listen pagesen per dosjet e perfunduara, (sipas formatit bashkangjitur ketij udhezimi).

- Liste pagesa e miratuar zyrtarisht nga titullari i Ministrise ose Institucionit Qendror i bashkangjitet kerkeses zyrtare dhe paraqitet per pagese prane Ministrit te Financave.
4. Ministri i Financave, bazuar ne liste pagesen bashkangjitur kerkeses, leshon Urdher-Pagesen per Banken e Shqiperise, e cila kryen trasfertat ne llogarite personale bankare te te shpronesuarve.

Ky udhezim hyn ne fuqi menjehere.

Ridvan BODE

MINISTER

Ne mungese dhe me porosi

Sherefedin SHEHU

ZV/MINISTER

